



Përshkrimi i shërbimeve

REISSWOLF dok. suite.

- Softuer për arkivim digjital: softuer si shërbim (SaaS - Cloud).
- Punoni në dokumente së bashku - në çdo kohë dhe nga çdo vend.
- I gatshëm për t'u përdorur menjëherë: pa investime në infrastrukturë IT apo kosto mirëmbajtjeje në vazhdimësi.
- Dokumentet mund të ndahen në mënyrë të sigurt me partnerët e biznesit ose midis ekipeve të projektit.
- Memorja dhe numri i pikave të aksesit mund të zgjerohen sipas nevojës.

REISSWOLF dok. suite.


Rritja e volumeve të të dhënave po paraqet një ndikim në rritje në proceset tona të biznesit. Me REISSWOLF dok. suite. ju mund t'i aksesoni dokumentet tuaja kollaj, në çdo kohë dhe nga çdo vend – qoftë direkt në shfletuesin tuaj ueb ose përmes aplikacionit. Zgjidhja jonë e arkivimit digjital mundëson menaxhimin e dokumenteve në mënyrë të auditueshme, me opsione praktike kontrolli dhe versionimi të të dhënave. Gjithashtu, rrjedhat e personalizuar të punës mund të konfigurohen dhe të përdoren me vetëm pak klikime.

- Ruajtje e skedarëve dhe e dokumenteve në mënyrë të auditueshme, në përputhje me kërkesat e mbrojtjes së të dhënave.
- Arkivi digjital mund të aksesohet nga çdo vend.
- Kategorizim dhe indeksim automatik i dokumenteve.
- Dokumentet e arkivuara mund të gjenden përmes kërkimit të tekstit të plotë "fulltext".
- Kontrolli i versionit regjistron të gjitha ndryshimet e bëra në dokument. Versionet e mëparshme mund të shfaqen në mënyrë retrospektive. Kjo minimizon humbjen e mundshme të të dhënave në rast të infektimit me viruse.
- Parametrizim praktik i autorizimit për mbrojtje optimale të të dhënave: të drejta të kontrolluara mbi leximin dhe modifikimin ndihmojnë ekipin të punojnë mirë së bashku.
- Takimet dhe detyrat ekzistuese mund të përdoren kollaj si shabllone për të rejat.
- Sistemi ofron rrjedha pune standarde, ashtu si edhe konfigurim praktik të rrjedhave të punës të përcaktuara nga përdoruesi.
- Softuer plotësisht i bazuar në ueb: nuk nevojitet instalim lokal në kompjutera apo në serverë.
- Siguri maksimale e të dhënave falë "datacenter"-ave të mundësuar nga një lider i tregut Gjerman.



Arkivimi

Dokumentet janë të disponueshme për të gjithë punonjësit. Struktura miqësore e paraqitjes së dosjeve me hierarki, është e mirëorganizuar dhe e vetëshpjegueshme. Qasja individuale dhe të drejtat e përdoruesit ofrojnë akses të sigurt në të dhënat.




Struktura e mirëorganizuar e dosjeve ofron transparencën e nevojshme të informacionit.



Aksesimi i Informacionit

Pavarësisht nëse përdorni smartfon, tablet apo kompjuter desktop, ju mund të aksesoni informacionin që ju nevojitet në pak sekonda, me një klik të mausit tuaj. Ju mund të përdorni REISSWOLF dok. suite. për të aksesuar të dhënat tuaja në çdo kohë dhe nga çdo vend. Kërkimi është një ndër funksionet kryesore të sistemit, krahas ruajtjes së të dhënave. Ju mund të zgjidhni midis kërkimit me tekst të plotë "fulltext" brenda përmbajtjes së dokumentit dhe kërkimit të drejtpërdrejtë për karakteristikat e tij. Kjo kursen kohë të vlefshme, veçanërisht kur keni të bëni me arkiva të mëdha dhe volume të gjera të dhënash.




Mund të përdoren një sërë cilësimesh autorizimi për të konfiguruar aksesin në dokumente.



Bashkëpunimi

Të jesh në gjendje të përdorësh proceset dhe risurset në mënyrë të koordinuar është thelbësore kur bëhet fjalë për të optimizuar zinxhirin e funksionimit të një kompanie. Me REISSWOLF dok. suite. ju mund të punoni me ekipe, grupe, apo kompani partnere të biznesit me baza të de-centralizuara, nga vende të ndryshme ose në kohë të ndryshme.




Me portalin online të REISSWOLF dok. suite., punonjësit kanë akses të plotë në të dhënat, në çdo kohë dhe kudo.



Siguria

Me serverët e tij në "datacenter"-a Gjermane me disponueshmëri të lartë, REISSWOLF ofron standarde maksimale të sigurisë për të dhënat tuaja. Për më tepër, dokumentet tuaja bëhen "backup" disa herë në ditë.

Dokumentet në REISSWOLF dok. suite. mund të redaktohen (editohen) aq shpesh sa ju nevojitet. Sa herë që bëhen ndryshime, krijohet një version i ri. Të gjitha versionet e një dokumenti ruhen me afat të pacaktuar.



Me REISSWOLF dok. suite. dokumentet menaxhohen në një mënyrë të mirëorganizuar dhe ruhen në përputhje me rregulloret për mbrojtjen e të dhënave.



Përputhshmëri Auditimi


Përputhshmëri me rregullat e auditimit, do të thotë që REISSWOLF dok. suite. i përmbush kërkesat mbi mbrojtjen e të dhënave dhe legjislacionin në fuqi.

Praktikisht, kjo do të thotë që çdo dokument arkivohet në formë të pandryshueshme, mund të aksesohet në çdo kohë dhe nuk mund të bëhet i papërdorshëm aksidentalisht ose si rezultat i viruseve. Ndryshimet ruhen veçmas dhe regjistrohen në ditarin elektronik.



Rrjedhat e Punës dhe Menaxhimi i Detyrave

REISSWOLF dok. suite. ofron një sistem të fuqishëm të menaxhimit të rrjedhave të punës. Rrjedhat individuale të punës mund të krijohen përmes "Workflow Designer". Mund të krijohen detyra për punonjës të veçantë, kolegë ose grupe përdoruesish. Veprimet mund të ekzekutohen automatikisht dhe pa ndërhyrje. Të gjitha hapat e rrjedhës së punës mund të kontrollohen dhe monitorohen. Një ndërfaqe moderne dhe intuitive ndihmon në dizajnimin e proceseve.





Ndërfaqet

Ndërfaqe të ndryshme mundësojnë integrimin e skedarëve në sistemin e REISSWOLF dok. suite. Kësisoj, dokumentet mund të ngarkohen përmes një API-je të fuqishme dhe t'u caktohen fjalë kyçe, karakteristika ose afate për fshirjen e tyre. Për më tepër, dokumentet mund të kopjohen edhe duke përdorur transferimin përmes "WebDav file transfer". Çdo klient ka një llogari personale emaili për të importuar dokumente edhe përmes emailit.

Akses në dokumentet tuaja në çdo moment - përmes aplikacionit.


I rregullt, i sigurt dhe gjithmonë disponibël. Me aplikacionin REISSWOLF dok. suite mund të shikoni, menaxhoni dhe redaktoni drejtpërdrejt dokumentet e ruajtura, edhe kur jeni larg zyrës. Kjo do të thotë që mund të keni korrespondencën e rëndësishme gjithmonë me vete, kudo që të jeni. Aplikacioni është i disponueshëm si për pajisjet Android, ashtu edhe për ato iOS.



App Store® është një markë e regjistruar e Apple Inc. Google Play dhe logoja e Google Play janë marka tregtare të Google LLC.



dok. suite.



Keni pyetje?
Na kontaktoni për përgjigje.
T +355 69 60 50 650
info@reisswolf.al

REISSWOLF Albania Sh.p.k.
Godina 33 tek stacioni i trenit,
Rruga Industriale, Kashar,
1051, Tiranë, Albania.
www.reisswolf.al

